

## SI E FORCON PERËNDIA BESIMIN TËND? Gjashtë Fazat e Besimit (1) Mateu 9:29 dhe Marku 9:23

Bibla thotë tek: **Mateu 9:29** (Jezusi tha) "U bëftë sipas *besimit tuaj*." Ky është çelësi i një aventure të madhe. Perëndia thotë: "Ti zgjedh sa do ta bekoj jetën tënde. Ti beso dhe Unë do ta bëj, ti beso dhe Unë do të jap, Unë do të bekoj."

**Marku 9:23** "Çdo gjë është e mundshme për atë që *beson*."

Çfarë e bën jetën të jetë një aventurë e madhe? Sa nga ju do të donit të kishit më shumë besim tek Perëndia? Unë do të doja. Për 6 ditë rresht në këtë kishë ne do të vazhdojmë serinë që po e fillojmë sot "Si e forcon Perëndia besimin tënd?"

Besimi është si muskujt—zhvillohet! Mund të forcohet më shumë se ç'është ose mund të dobësohet. E gjitha varet nga ti, sesa shumë do ta përdorësh. Nëse mendon që besimi yt është i dobët mos mungo të dielat e ardhshme.

*Si e forcon Perëndia besimin tim?* Ai përdor një model shumë të thjeshtë, një proces të thjeshtë. Nëse ti arrin ta kuptosh, mund të bashkëpunosh me Të.

Unë mendoj që kjo do të jetë seria më e rëndësishme për këtë vit sepse Bibla thotë, "Pa besim, është e pamundur ti pëlqesh Perëndisë."

Pyetja që më bëhet më shpesh është: "Pse po më ndodh kjo gjë mua? Unë se kuptoj dot, pse mua?" Nëse nuk i kupton 6 hapat sesi Perëndia e ndërton karakterin dhe ndërton besimin tënd, e vërteta është që ti ke për t'u zhgënjyer. Madje edhe mund të hidhërohesh dhe me siguri që do të shqetësohesh. Mund edhe të ndiesh frikë për të ardhmen; dhe më e keqja akoma, nuk mund të bashkëpunosh me Perëndinë. Kur e kupton sesi Perëndia do që çdo besimtar të kalojë nëpër këto 6 hapa, atëherë ke për të thënë, "Ooh tani e kuptoj, unë jam tek hapi 4 i besimit tim tani." Apo 6 apo 2.

Kupto se çfarë po të ndodh dhe mos u zhgënje kur ditët vështirësohen!

Unë dua që ti bëj një hyrje kësaj serie sot. Ne do të mësojmë sesi ti kuptojmë "6 Hapat e Besimit."  
***Si e Forcon Perëndia Besimin Tim?***

### 1. Ëndrra, vizioni.

Perëndia gjithmonë e fillon me një ëndërr. Nuk ka për të ndodhur asgjë derisa dikush të fillojë të ëndërrojë. Ti ndoshta ke një ide, një vizion, një qëllim, synim, një ambicie, sepse ti si secili prej nesh do ta fiksosh vëmendjen tek diçka.

Kur Perëndia do që të punojë në jetën tënde, Ai gjithmonë do të japë ty një ëndërr—në lidhje me jetën tënde, në lidhje me atë që Ai do që ti të bësh, në lidhje me ndikimin që Ai do që të sjellësh ti në këtë qytet dhe vend.

Ka shumë shembuj në Bibël në lidhje me ëndrrat e ndryshme, vizionet që Perëndia u dha personave të ndryshëm.

*Perëndia i dha Noeut ëndrrën për të ndërtuar një arkë.*

*Perëndia i dha Abrahamit ëndrrën që të bëhej babai i një kombi të madh.*

*Perëndia i dha Jozefit ëndrrën që ai do të ishte si një urë që do të shpëtonte njerëzit e familjes së tij.*

*Perëndia i dha Nehemias ëndrrën për të ndërtuar një mur rreth Jeruzalemit.*

*Perëndia i dha Davidit ëndrrën për të ndërtuar një tempull.*

Nuk ka për të ndodhur asgjë derisa ti të fillosh të ëndërrosh.

Por nga ta kuptosh që një ëndërr është nga Perëndia ose është nga vetja jote? Ndoshta kjo është ajo që po mendon ti tani: “*Nga ta di unë që është Perëndia që po më flet mua, dhe nuk është nënvetëdija ime? Kush po ma sjell këtë gjë në jetën time?*”

**Efesianëve 3:20** “...Perëndia, me anë të fuqisë që vepron në ne, *mund të bëjë jashtë mase më tepër nga sa kërkojmë ose mendojmë* (shumë më shumë sesa ne do të guxonim t’i kërkonim apo të ëndërronim, pa masë, përtej lutjeve tona, dëshirave, mendimeve apo shpresave tona.)”

Ëndrra që të jep Perëndia do të kërkojë besim. Nëse një ëndërr vjen nga Perëndia, do të jetë aq e madhe saqë ti vetë nuk e realizon dot. Nëse arrin ta realizosh vetë nuk do të kesh nevojë për besim, dhe nëse nuk ke nevojë për besim për të arritur diçka, ti nuk po i sjell kënaqësi Perëndisë sepse Bibla thotë: “Nëse diçka nuk bëhet me besim është mëkat.”

Perëndia fillon duke të dhënë ty një ëndërr. Ai ka qenë duke u folur shumë prej jush, ti thjesht nuk e ke kapur. Ajo ëndrra, ajo ideja, ai koncepti, ajo gjëja që do ti sillte përfitime njerëzve të tjerë—nga mendon se erdhi ajo ide te ty? Të ka ardhë nga Perëndia.

Dëshira e Perëndisë, vullneti i Tij nuk bie në kundërshtim. Ai nuk do të japë ty një ëndërr të tillë: “*shko bëj këtë gjë, që ti të bëhesh dikush dhe më i famshëm se të gjithë, aktor filmash, shko në Hollivud fare*”. Nuk është një ëndërr nga Perëndia, nëse ka të bëjë vetëm me ty dhe nëse personi i vetëm që përfiton je ti. Vullneti i Perëndisë nuk bie në kundërshtim me Fjalën e Perëndisë, janë të lidhura të dyja bashkë.

Pra, Ai e fillon me një ëndërr. Ky është vetëm hapi i parë.

## **2. Vendimi – ti fillon të bësh diçka në lidhje me ëndrrën tënde.**

Asaj ëndrre nuk ka për ti ndodhur asgjë derisa, ti të zgjohesh dhe të fillosh të veprësh. Ti je ai, që do ta realizosh. Duhet të vendosësh: “*A do të jepem pas kësaj apo jo?*” Një anketë, ndër 10 persona vetëm njëri prej tyre vendos për ta realizuar ëndërrën. Shumë njerëz kanë ëndërra por ata kurrë nuk e kalojnë Hapin Dy—Nuk vendosin për ta realizuar.

Tek Jakobi 1:6+8 thuhet: “*Le ta kërkojmë me besim, pa dyshuar...një njeri me dy mendje, është i paqëndrueshëm në të gjithë rrugët e veta.*”

Besoj është folje—është diçka aktive dhe jo pasive. Është diçka që ti bën, jo rri e pret pa bërë gjë. Kur merr një vendim, ti e merr me besimin që do të ndodhë. Përdore muskulin e besimit.

Përgjatë këtij hapi—momenti i vendosjes është të bësh dy gjëra.

- **Investo: vendos për të investuar.**
  - a) Kohën tënde
  - b) Lekët
  - c) Reputacionin Tënd/
  - d) Energjitë e tua.

Tek Hapi dy ka një moment ku kërkohet që ti të investosh në këtë vendim që po merr. Hidhe hapin, dhe thuaj, “*Perëndi, Ti më ke kërkuar që unë të bëj këtë gjë dhe unë po ia filloj.*”

- **Lëre: hiq dorë nga gjërat e sigurta.**

Ti nuk mund të lëvizësh përpara me besim dhe ta kesh dorën të kapur mbrapa tek e shkuara në të njëjtën kohë. Duhet të lëvizësh përpara, hiq dorën. Abrahamit Perëndia i tha: “Unë do të bëj ty babain e një

kombi të madh.” Ai duhej të linte shtëpinë e tij për të ikur diku ku s’kishte qenë asnjëherë më parë. Hoqi dorë nga vendi i tij.

Mosiu hoqi dorë nga mundësia për t’u bërë Faraon, kur të vdiste Faraoni, do të ishte Moisiu që mbretëronte. Ai hoqi dorë që të bënte vullnetin e Perëndisë. Nehemia hoqi dorë nga puna e tij e sigurtë në mënyrë që të ndërtonte murin rreth e qark Jeruzalemit. Nëse ti do që të ecësh mbi ujë, atëherë duhet të dalësh nga varka, siç bëri Pjetri.

Shembulli më i mirë i kësaj janë artistët e cirkut, ata që bëjnë gunglime. I hedhin topat nga 4-5 prej tyre. Këto topa që hedh ai, janë aq larg nga njëri tjetri saqë ngelet kohë me e kap tjetrën dhe me e hedh lart; ndërkohë që, dy të tjerat bien poshtë. Në një moment duhet ta hedhësh një top, që të jesh në gjendje për të kapur tjetrin dhe të gjitha lëvizjet ndahen me një pjesë të sekondit.

Nëse nuk vendos, nëse nuk heq dorë nga ajo që po të jep siguri, nëse je rehat aty; atëherë kjo do të pengojë ty të ecësh përpara. Perëndia të jep ty një ëndërr dhe ti lëviz përpara.

### 3. Vonesa.

Perëndia nuk do ta plotësojë ëndrrën tënde menjëherë. Ai nuk ka premtuar që, nëse ta jep ëndrrën sot, nesër ka për t’u realizuar. Asnjëherë nuk matet nga koha fikse, sepse gjithmonë ka një moment, një kohë vonese, një kohë pritje.

**Habakuku 2:3a** *Perëndia tha: "Sepse vegimi (vizioni, ëndrra) është për një kohë të caktuar, por në fund ai do të flasë dhe nuk do të gënjejë; nëse vonon, prite, sepse me siguri do të vijë dhe nuk do të vonojë."*

Në hapin 3, ti fillon dhe bën pyetjen “Kur? Kur o Zot? Kur do t’i përgjigjesh lutjes sime?” Njerëzit në përgjithësi nuk e pëlqejnë “pritjen”. Nuk na pëlqen të presim në kafene apo restorant, apo kur jemi në trafik; mezi presim semaforin të bëhet jeshil. Ajo që e kemi më shumë inat, është kur na duhet të presim Perëndinë për diçka. A ke qenë me nxitim për diçka dhe duket sikur Perëndia e ka marrë shtruar? Kjo gjë të acaron ty, por jo Perëndinë. Ai do që të punojë tek ti, përpara se të fillojë të punojë tek ai projekt, tek ajo ëndërr.

Çdo besimtari përgjatë gjithë historisë, i është dashur të shkojë në “Universitetin e Pritjes”, për Mësuar “Si të presë”. Disa nga ju akoma nuk jeni diplomuar nga ky universitet.

- Noeu priti 120 vjet që të realizohej ëndrra që i dha Perëndia, nga momentin që filloi të ndërtonte arkën, e deri kur filloi shiu; 120 vjet.
- Abrahamit iu tha kur ishte 75 vjeç që do të bëhej baba i një kombi të madh dhe deri kur u bë 99 vjeç nuk pati asnjë fëmijë.
  - Perëndia i tha Moisiut që ai do të ishte drejtuesi me të cilin Perëndia do ti çlironte njerëzit e Tij nga skllavëria 400 vjeçare dhe Perëndia e la Moisiun të priste 40 vjet.
  - Jezefi kaloi disa vite në burg përpara se Perëndia ta ngrinte lart dhe e bëri kryeministrin e një shteti, ashtu siç desh Perëndia.
  - Perëndia vajosi Davidin si mbret dhe atij iu desh të priste disa vite derisa të fillonte të mbretëronte si mbret.
  - Madje kur Jezusi erdhi në tokë si Mesia, si Shpëtimtari i botës ai priti 30 vjet në shtëpinë e një zdrukthëtari.

Të gjithë duhet kalojmë në këto periudhat e pritjes. *Por përse të presim?*

Pritja na mëson që të kemi besim tek Perëndia. Ne mësojmë që koha e Perëndisë është perfekte.

Një gjë që kurrë nuk duhet harruar është që Perëndia thotë: *“vonesat kurrë nuk e ndalojnë qëllimin Tim. Vonesa nuk është harresë, fëmijët duhet të mësojnë ndryshim e “Jo-së” dhe “Jo akoma.”* Është ndryshim i madh apo jo?

Shumë herë Perëndia të thotë ty: *“Akoma jo.”* Ndërkohë që ti mendon që Perëndia po të thotë: *“JO.”* Vonesa nuk është harresë, vonesa nuk e shkatërron kurrë qëllimin e Perëndisë për jetën tënde. Reagimi normal në këto raste është dyshimi. Fillon dhe dyshon - *“Ndoshta nuk ishte ky vizioni, ëndrra e Perëndisë për mua, ndoshta ishte ideja ime.”*

*Si të presësh në Dhomat e Pritjes në jetë?*

Kjo kohë pritje e tregon besimin tënd. Pastaj, ti fillon të lëvizësh nga koha e vonesës për tek hapi i katërt i plotësimit të ëndrrës tënde.

#### **4. Vështirësitë**

Shiko, jo vetëm që duhet të presësh, por dalin edhe probleme ndërsa pret. Dy lloje problemesh: *“Probleme me Rrethanat rreth teje”* dhe *“Kritikat. Mbye mend këtë sepse kur Perëndia të jep ty një ëndërr ke për të hasur pengesa dhe rrethana të vështira.*

Moisiu pati vështirësi. Kur ai drejtoi popullin e Izraelit nga Egjipti përmes shkretëtirës për tek toka e Premtuar, ai pati problem pas problemi. Në fillim nuk kishin ujë, pastaj nuk kishin bukë. Ai kishte një grup të madh që vetëm ankoheshin, pastaj pati gjarpërinj helmues që pickuan shumë njerëz. Problem pas problemi. Ata ishin duke bërë atë që donte Perëndia por ama patën shumë probleme.

Davidi u vajos si mbret, por për disa vjet ai u ndoq nga mbreti aktual Sauli i cili donte ta vriste. Për disa vite me rradhë, Davidit iu desh të fshihej nëpër shpella.

Jozefi pa një ëndërr që do të bëhej i pari i vëllezërve, por për shkak të ëndrrës e shitën si skllav. U akuzua për përdhunim pa të drejtë, ai ishte në pikë të hallit dhe asnjeri nga shtëpia e tij se kishte idenë se ku ishte; madje i ati e qau për të vdekur.

Vështirësitë janë pjesë e vonesës!

A mund të imagjinosh vështirësitë që ka patur Noeu? Si mund të ndërtosh një arkë kur nuk ke pikë uji vërdallë? Është sikur të ndërtosh “Titanikun” mbi një mal.

Lloj lloj problemi do të dalë. Bibla thotë që kur vdiq Moisiu, Jozueu u zgjodh si drejtues. Mosiu e drejtoi popullin përmes shkretëtirës, tani Jozueu do ta drejtonte popullin në tokën e premtuar.

Duket sikur kjo ishte pjesa më e lehtë, ai po i udhëhiqte ata në tokën e premtuar dhe vargu tjetër thotë, *“Në atë tokë kishte gjigandë.”* Madje edhe në tokën e premtuar kishte probleme, dhe kjo ndodh sepse Perëndia po punon tek besimi dhe karakteri yt.

***Përse i lejon Perëndia vështirësitë? 1 Pjetrit 1:6-7*** *“Në qoftë se duhet, për pak kohë, tani duhet të trishtoheni nga prova të ndryshme, që prova e besimit tuaja, që është shumë më i çmuar nga ari...”*

Pastaj, vështirësitë bëhen aq të mëdha, sa që ty të humbet durimi, ti ke provuar çdo gjë, je i raskapitur pasi i ke provuar të gjitha mundësitë.

#### **5. Rrugë pa Krye**

Situata kthehet nga *“e vështirë”* në *“e pamundur”*! E pa shpresë, nuk ia vlen, nuk bëhet, nuk ke mundësi tjetër, kthehu.

Nëse je në këtë fazë, në këtë hap të ëndërrës tënde, urime. Urime sepse nuk je vetëm, ka edhe shumë të tjerë si ti. Madje edhe Pali arriti në rrugë pa krye **2 Korintasve 1:8-9** Ai tha: “...u rënduam përtej fuqive tona, aq sa u dëshpëruam edhe për jetën vetë. Për më tepër ne kishim në veten tonë vendimin e vdekjes, që të mos besonim në veten tonë, por në Perëndinë që ringjalli të vdekurit.”

Nëse Perëndia ka mundësi të ringallë njerëzit nga ana fizike, Ai mund ti ringjallë dhe nga ana emocionale. Ai mund të ringjallë një punë pa krye, një familje me probleme, një martesë me probleme. Nëse Perëndia mund të ringjallë të vdekurit Ai mund të bëjë çdo gjë.

Në situatën e Abrahamit, Perëndia i tha, “Unë dua që ti të bëhesh ati i një kombi”, pastaj atij i duhet të presë deri në moshën 100 vjeç që të bëhej me fëmijë. Bibla thotë që ai kaloi nga situatat të vështira në situata të pamundura. Ai shikon veten, trupin e tij të plakur, dhe thotë, “Jo, s’ka mundësi!” Pastaj shikon gruan e tij, dhe i dyfishohet dyshim, “Jo, është tërësisht e pamundur.” Por, Sara ngeli shtatzënë dhe ata qeshën me të madhe për këtë gjë, prandaj djalit të tyre ia vunë emrin Isak që do të thotë “Qeshje, qesha”. Ne e dimë që Sara nuk i besoi Perëndisë kur i thanë asaj që do të linte një fëmijë, sepse ajo qeshi. Nëse do ti kishte besuar Perëndisë për të lindur në atë moshë që ishte ajo, nuk do të kishte qeshur por do të kishte qarë.

Perëndia shpesh i lë problemet të kthehen në vështirësi. Dishepujt vendosën që ta ndiqnin Jezusin. Ata menduan që Ai ishte Mesia, Shpëtimtari. Pas 3 vitesh, e panë që ua morën e kryqëzuan dhe Ai vdiq. Rrugë pa krye për dishepujt, për tre ditë ata ishin në një rrugë pa krye, rrinin brenda.

Kur je në këtë hap të ëndërrës tënde, në këtë fazë ti fillon dhe pyet, “Çfarë po më ndodh Perëndi? A mos jam unë jashtë vullnetit Tënd? Jashtë planit Tënd? A mos nuk është kjo ëndërra Jote për jetën time? Mos e sajova unë vetë këtë gjë?”

Shembulli më i mirë për këtë është kur Moisiu po drejtonte Izraelitët për ti nxjerrë nga Egjiptit. Kishin qenë skllëvër në Egjipt për 400 vjet. Më në fund Faraoni, pas 10 fatkeqsish, tha: “*Ikni, largohuni përgjithmonë nga vendi im.*” Ata ikën, por një ditë më vonë Faraoni ndryshoi mendje dhe filloi ti ndiqte nga pas. Ata ishin tek Deti i Kuq, në të dyja anët kishte male, Deti i Kuq përballë, armiku nga mbrapa gati për ti vrrarë. Ishin në pikë të hallit, nuk kishte pikë shansi për të shpëtuar të gjallë. Shumë njerëz do të jenë ankuar “Pse nuk ndenjëm në Egjipt?!” , “Ishim më mirë atje, tani do të vdesim këtu para detit të Kuq.”

Ka njerëz që më mirë preferojnë të rrinë në pranga, sesa të rrezikojnë. Më mirë rrinë në një situatë që e dinë që nuk është vullneti i Perëndisë, sesa të rrezikojnë dhe pastaj do t’u duhet të varen tek besimi i tyre, tek Perëndia. Të rrezikojnë të jenë të lirë, t’u krijohet mundësi e re, të rrezikojnë të merren me problemin.

Është interesate sepse vendi ku ishin ata në atë moment, në atë rrugën pa krye, quhej Baal-Tsefon. Që do të thotë, “thesari i fshehur i Perëndisë.” Ata ishin tamam në vendin ku duhet të ishin. Nëse ti në këtë moment mendon që ti dhe ëndrra jote jeni në një rrugë pa krye, ti je ekzaktësisht aty ku do Perëndia që të jesh. Perëndia e di se ku je ti, Ai po të shikon. Ai e di numrin e fijeve të flokëve që ke në kokë. Ai ka lejuar që ti të jesh në atë rrugë pa krye me një qëllim. “Rrugët pa krye janë pjesë e planit të Perëndisë për mua.”

Ti ke për të patur shumë rrugë të tilla në jetë. Por kujtohu, ky është hapi i 5, faza e pestë.

Cili është reagimi, qëndrimi më i mirë kur je në një rrugë pa krye?

“*I cili na ka çliruar dhe...do të na çlirojë edhe më.*” **2 Korintasve 1:10**

“*Oh sikur të isha i sigurtë të shoh mirësinë e Zotit...Ki besm të madh te Zoti...*” **Psalmi 27:13+14a**

Ki pritje. Ki pritje pozitive, pritje të mira që Perëndia do të drejtojë ty në hapin e 6.

## 6. Plotësimi

Në fund, Perëndia sjell plotësimin e ëndrrës. Perëndia bën një mrekulli. Perëndia siguron mundësinë, zgjidhjen.

Kështu ndodh gjithmonë. Në rastin e Moisiut, Perëndia e ndau detin e Kuq në dy pjesë.

Në rastin e Abarahamit, ai dhe Sara u bënë me fëmijë.

Në rastin e Jozefit, ëndrra e tij u bë realitet dhe ai e gjen veten i dytë pas mbretit të Egjiptit.

Në rastin e Jezusit, Ai u ringjall.

Perëndisë i pëlqen t'i kthejë të gjitha kryqëzimet në ringjallje. Rrugët pa krye në plotësime. Kur e bën këtë gjë, Ai e merr meritën, Ai e merr lavdinë. Reagimi më i mirë kur je në një rrugë pa krye është; prit që Perëndia të veprojë. Çfarë je duke pritur që Perëndia të bëjë në jetën tënde? Ai po bën atë gjë, që ti je në pritje. Bibla thotë: *“Do të bëhet sipas besimit tënd.”* Kur ti pret për plotësimin e ëndrrës, Perëndia i merr meritat.

Kisha e Tiranës, kjo kishë është një shembull i gjallë, i këtyre 6 hapave. Ne jemi duke kaluar për herë të dytë këto gjashtë hapa.

Kisha filloi me Hapin 1, një ëndërr. Ishte diçka që unë e dija që nuk do të ndodhte me fuqitë dhe aftësitë e mija; që ose Perëndia duhet ta bënte, ose nuk do të ndodhte kurrë.

Unë e dija që kjo ëndërr ishte nga Perëndia, dhe u sigurova mirë para se të fillonim.

Pastaj lëvizëm në Hapin 2. Disa prej jush kanë qenë pjesë e këtij vendimi, e këtij hapi ku secili ka investuar dhe po investon nga vetja e tij; kohën, aftësitë, dhuntitë, energjinë, lekët. Muaj pas muaji. Satani nuk ka për t'u dorëzuar dhe ta lërë këtë kishë të ketë çdo gjë që do. Duhet luftuar për çdo centimetër, një betejë këtu, një atje. Gërat nuk ndodhin rastësisht, janë vonesa të planifikuara. Ata po ndërtojnë karakterin tonë, ne po fitojmë edhe një betejë, dhe një tjetër.

Kemi vështirësi, për 16 muaj kemi ndërruar 3 herë vendin e kishës. Rrugë pa krye. Na kanë humbur disa mundësi, herë pas here vështirësi financiare. Ne kemi dhe jemi duke luftuar me vonesat, vështirësit, rrugët pa krye. Dhe të gjitha këto janë pjesë e planit të Perëndisë.

Por, pastaj do të vijmë tek plotësimi, sepse ne nuk kemi ndërmend të dorëzohemi dhe për shkak se besojmë, Perëndia po vepron dhe do të veprojë sipas besimit tonë.

Unë dua që Kisha e Tiranës të njihet si *“Kisha që ka shumë besim”*, *“Që po merr shumë nga Perëndia sepse po beson shumë.”* Perëndia po i përdor shumë, sepse ata besojnë *“që çdo gjë është e mundur me anë të besimit.”*

### Lutje përkushtimi:

**Hapi 1** – Cila është ëndrra që më ka dhënë Perëndia mua?

Nëse ti akoma nuk ke një ëndërr, fillo të lutesh: *“Perëndi më jep mua një ëndërr.”* Nëse nuk di se çfarë të shkruash tek hapi 1, ajo që duhet të bësh është fillo dhe lutu. Nëse nuk e ke një ëndërr ti nuk po jeton, ti po ekziston. Perëndia të ka vënë ty në tokë për një qëllim dhe kur ti e zbulon atë qëllim, atëherë do të kuptosh se ajo është ëndërra jote; ajo që Perëndia do që ti të bësh.

**Hapi 2** – Ti ke marrë një ëndërr nga Perëndia por akoma nuk ke vendosur se çfarë do të bësh me të!

Ti je akoma në vend numëro. Fjala e Perëndisë për ty, nëse je në Hapin 2 është *“Jepi, është momenti!”*

Disa nga ju sot, në këtë dhomë duhet të merrni vendimin t'ia dorëzoni jetën tuaj Krishtit. Disa nga ju duhet të marrin vendimin për t'u pagëzuar. Disa nga ju duhet të marrin vendimin për t'u bërë pjesë e kësaj kishe. Disa nga duhet të vendosni, a duhet të hedh një hap në besimin tim ashtu siç bëri grupi prej 12 vetësh mbrëmë, tani që je anëtar, të bëhesh dishepull.

**Hapi 3** – *Pse po vonohet ëndrra ime? Nëse lutja jote nuk po plotësohet, nuk ka problem. Ti je në momentet e pritjes. Mos u dorëzo. Kur gjërat nuk ndodhin atëherë kur duam ne, ne tentojmë dhe nxitojmë para Perëndisë dhe krijojmë mënyrën tonë për ta bërë atë që duam. Por ka shumë mundësi që do të marrësh vendimin e gabuar. Prit, prit, prit që dora e Perëndisë të veprojë në atë gjë.*

**Hapi 4** – *Me çfarë vështirësish jam përballur ndërsa po pres që ëndërra të realizohet? Ti po testohesh, por nuk ka për të qenë testi i fundit. Në jetë ke për të kaluar nëpër shumë sprova. Perëndia thotë, “Unë e di se nëpër çfarë shtate je duke kaluar. E shikoj. Aty i kam sytë. Mos mendo kurrë që Unë të kam harruar, sepse s'të harroj dot”.*

**Hapi 5** – *A ke arritur tek rruga pa krye? Disa nga ju mund të jenë aty dhe gati për të hequr dorë. Ti je aty ku do Perëndia. Ti po bëhesh gati për Plotësimin e Ëndrrës. Fjala e Perëndisë për ty është “Mos u dorëzo! Vazhdo të besosh! Mos lësho pe!”*

**Hapi 6** – *A pres unë që Perëndia ta plotësojë ëndërrën që më ka dhënë? Ai do ta bëjë, “Do të bëhet sipas besimit tënd.” Perëndia është besnik, atë që kërkon Ai nga ne, ka për ta bërë. Por, nuk ndodh brenda një nate.*

Sepse ti duhet të kalosh kohën e Ëndërrimit, Vendimit, Vonesës Vështirësisë, Rrugës pa krye. Pastaj vjen Plotësimi.

**Lutje shpëtimi:**